

KËSHILLI DREJTUES

V E N D I M

Nr. 13, datë 28.03.2019

Për miratimin e një shtese në Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 17, datë 28.07.2016 “Mbi miratimin e Rregullores për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave” të ndryshuar

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, pika 1, shkronja “l” dhe shkronja “m”, të nenit 52, pika 1, shkronja “i”, të nenit 59, pika 1 të ligjit nr. 53/2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të Udhëzimit nr. 21 datë 22.06.2018 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për disa shtesa në Udhëzimin nr.31 datë 26.12.2013 “Për emetimin nga Qeveria e Shqipërisë të Obligacioneve në formë rregjistrimi”, të nenit 8, shkronja “l” të Vendimit të Këshillit Drejtues nr. 17, datë 28.07.2016 “Mbi miratimin e Rregullores për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 8, pika 3, shkronja “j” të vendimit të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm:


V E N D O S I:

1. Në Rregulloren “Për politikën e administrimit të mjeteve financiare të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, bashkëlidhur vendimit të Këshillit Drejtues nr. 17, datë 28.07.2016, të ndryshuar, pas nenit 17 të shtohet neni 17/1, me përmbajtjen si vijon:

Neni 17/1

*Investimi në tituj në tregun financiar vendas
nëpërmjet ndërmjetësimit ose tregtimit, si dhe ruajtja e tyre*

1. *Investimi i mjeteve financiare të Agjencisë në tituj të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Autoriteti Mbikëqyrës, në lek ose në monedhë të huaj, realizohet, përveç pjesëmarrjes së saj të drejtpërdrejtë në tregun primar, edhe nëpërmjet ndërmjetësimit nga bankat e nivelit të dytë ose*



KËSHILLI DREJTUES

institucione të tjera financiare, që operojnë në Republikën e Shqipërisë të përzgjedhura nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, si zhvillues të tregut. Agjencia hyn në marrëveshje kontraktuale me zhvilluesit e tregut të përzgjedhur nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, me qëllim investimin në tregun primar.

- 2. Agjencia, kur e vlerëson të nevojshme, kryen veprime tregtimi blerje/shitje në tregun sekondar, të titujve të emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë ose Autoriteti Mbikëqyrës, në lek ose në monedhë të huaj, me bankat e nivelit të dytë ose institucione të tjera financiare, që operojnë në Republikën e Shqipërisë, veprimtaria e të cilëve mbikëqyret nga një autoritet rregullator.*
- 3. Në çdo rast, ruajtja e titujve të blerë nga Agjencia sipas pikës 1 dhe 2 të këtij neni, kryhet nga Autoriteti Mbikëqyrës, si kujdestar i titujve nëpërmjet sistemit AFISaR.”*
2. Ngarkohet Komiteti i Investimeve, Sektori i Financës dhe Investimeve dhe Sektori i Analizës së Riskut për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Martin Blushi

Sekretar

Donald Duraj

Kryetar